



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 33 datë 13.6.2022**

**“PËR ANGAZHIMIN E BURIMEVE FINANCIARE TË BASHKISË SHKODËR  
PËR BASHKËFINANCIM NË APLIKIMIN ME NR. REF: EU4M-CFP1-A2; PËR  
ANGAZHIMIN PËR MBULIMIN E KOSTOVE TË MIRËMBAJTJES SË  
PROJEKTIT DHE PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT PËR LIDHJEN E  
KONTRATËS SË GRANTIT”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 13.6.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; udhëzimit nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”; Letrës së njoftimit për përzgjedhjen e propozimit të Bashkisë Shkodër për lidhjen e kontratës me Nr. 108 Prot., datë 24.05.2022; Shkresës për marrjen në dorëzim të aplikimit datë 15.04.2022; VKB nr. 16, datë 31.03.2022 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër”; VKB nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë;

**VENDOSI:**

1. Të miratohet projekt-angazhimi për kontratën e grantit me Autoritetin Kontraktues “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS, dega Shqipëri, në kuadër të thirrjes për propozime Skema e Granteve “BE për Bashkitë” (EU4M). Projekti financohet nga Bashkimi European dhe do të

udhëhiqet dhe zbatohet nga Bashkia Shkodër. Ky projekt do të përfshihet në programin 09240 “Arsimi i mesëm profesional”, ku shuma e parashikuar e vlerës totale të projektit është 195,920 Euro (23,510,400 lekë), nga të cilat Projekti do të financojë shumën 176,225 Euro (21,147,000 lekë), kontribut i bashkisë me staf ekzistues do të jetë bashkëfinancimi në masën 10.05% në vlerën 19,695 euro (2,003,400 lekë), TVSH 20% për investime dhe garanci 5 % në vlerën 36,500 euro (4,380,000 lekë).

2. Të miratohet në parim bashkëfinancimi i shumës 36,500 euro (4,380,000 lekë) për TVSH në vlerën 29,910 euro (3,589,550 lekë) dhe për 5% në vlerën 6,590 euro (790,450 lekë), në programin 09240 “Arsimi i mesëm profesional”. Ky fond do të planifikohet me rialokimet e gjendjeve të fondeve nga viti 2021.
3. Të miratohet angazhimi për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes të godinës pas përfundimit të projektit në aplikimin me nr. ref: EU4M-CfP1-A2 – “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”.
4. Të miratohet dhënia e autorizimit Kryetarit të Bashkisë Shkodër për lidhjen e kontratës së grantit me Autoritetin Kontraktues “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS, dega Shqipëri, Skema e Granteve “BE për Bashkitë” (EU4M).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 17.6.2022